



WIKIPEDIA
The Free Encyclopedia

Citimi i burimeve në Wikipedia

Citimet janë shumë të rëndësishme për t'a bërë artikullin tuaj në Wikipedia të besueshëm. Ja se si duhet të citoni burimet në artikujt që shkruani.

Një parim thelbësor i Wikipedias është që faktet e shtuara në enciklopedi duhet të jenë të verifikueshme. Me fjalë të tjera, gjithçka që shkruani në Wikipedia duhet t'i atribuohet një burimi të besueshëm: një reviste shkencore, libri ose një artikulli gazete/portali të besueshëm.

Në përgjithësi, duhet të citoni së paku një herë për çdo paragraf që shkruani në Wikipedia, por citatat, faktet e forta si statistikat apo pohimet potencialisht të kontestueshme duhet patjetër të citohen. Çdo informacion që shtoni i cili nuk është i cituar nga një burim ka gjasa të fshihet nga Wikipedia, prandaj citimet janë pjesë e rëndësishme e punën suaj.

Mos harroni, Wikipedia nuk lejon hulumtime vetanake. Një artikull i Wikipedia-s në asnjë moment nuk duhet të lidhë dy pjesë të informacionit nga burime të ndryshme për të arritur një përfundim të ri. Në vend të kësaj, ju duhet të gjeni një burim që tregon mu atë përfundim të cilin dëshironi ta citoni. Merrni si shembull këtë fjali: "Agjencia Botërore Anti Doping u krijua në vitin 1990[1], por doping u rrit gjatë viteve 1990[2]." Të dyja deklaratat mund të jenë fakte nga burime të besueshme të cilat mund të citohen veç e veç, por nuk do të duhej të kombinoheshin brenda një fjalie, duke nënkuptuar lidhje.

Para se të filloni



Shikoni për artikuj të zgjedhur ose artikuj të mirë në fushën e disiplinës në të cilën po shkruani dhe shikoni se si autorët e këtyre artikujve citojnë burime. Disa disiplina, siç janë shkencat biomjekësore, kanë kërkesa shtesë për citime. Disa disiplina favorizojnë atributet brenda tekstit, ku ju duhet të shtoni në fjali emrin e autorit pasi që shtoni faktin.



Citimi në Wikipedia nuk ka ndonjë stil të vetëm të pranueshëm për të referencuar punën tuaj në Wikipedia, siç është stili MLA apo APA. Megjithatë, ju duhet të mbani një stil të qëndrueshëm përgjatë gjithë artikullit.



Nëse jeni duke përpunuar një artikull ekzistues, të gjitha referencat duhet të jenë në të njëjtin stil që është përdorur në artikull. Kujdesuni të mbani çdo citim që redaktorët e mëparshëm kanë shtuar në artikull. Një mënyrë e thjeshtë për të mbajtur citimet tuaja në përputhje - dhe për të shtuar citime në përgjithësi - është përdorimi i veglës së citimit. Ja se si mund ta përdorni.



WIKIMEDIANS
OF ALBANIAN LANGUAGE
USER GROUP




WIKIPEDIA
The Free Encyclopedia

Citimi i burimeve në Wikipedia

Citimet janë shumë të rëndësishme për t'a bërë artikullin tuaj në Wikipedia të besueshëm. Ja se si duhet të citoni burimet në artikujt që shkruani.

Përdorimi i veglës për citim


Për të përdorur veglën e citimit klikoni fjalën "Burimi" në panelin e veglave në dritaren e redaktimit. Kjo do ju shfaqë një meny ku mund të zgjidhni formularin për faqet e internetit, gazetat, librat dhe revistat shkencore, burimet më të zakonshme që përdoren në Wikipedia. Nëse klikoni një nga këto, do të shihni një formular që ju kërkon të jepni informacionin për burimin tuaj. Plotësoni formularin për aq sa keni informacion.



Emri i parametrimit

- Source date** date
Full date when the source was published; if unknown, us...
- URL access date** accessdate
The full date when the original URL was accessed; do n...
- Website title** website
Title of the website; may be wikilinked; will display in itali...
- Publisher** publisher
Name of the publisher
- Last name** last
The surname of the author; don't wikilink, use 'authorlink'...
- First name** first
Given or first name, middle names, or initials of the auth...

Ju mund të ri-përdorni të njëjtin burim disa herë brenda artikullit. Vendoseni kursoren te fjala ku doni të vendosni referencën, zgjedhni veglën "Burim", zgjedhni "Ri-shfrytëzo" dhe zgjedhni referencë që doni.



Në fund të artikullit shtoni një nëntitull të nivelit 2 ==Referencat==. Poshtë këtij nëntitulli shkruani:{{Reflist}}. Vegla në formë automatike do ju shfaqë listën e plotë të referencave të cilat i keni përdorur gjatë citimit të artikullit.

Për më shumë:
www.wikimediashqip.org



WIKIMEDIANS
OF ALBANIAN LANGUAGE
USER GROUP

@SQWikimediansUG
@SQWikimediansUG
@SQWikimedians_UG